



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

i mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa i Komunës së Prishtinës, mbajtur më 23.1.2025.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina - kryesues i komitetit, Nora Kelmendi (VV), Mirsad Vitia (VV), Arbnora Berisha (VV), Gëzim Sveçla (VV), Jeta Rafuna (LDK), Dhurata Jahaj - Retkoceri (LDK), Shegë Beqiri - Badivuku (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK) dhe Bahri Gashi (AAK).

Mungoi: Milazim Vitija (LDK).

Të pranishëm ishin edhe: Arbër Sadiki - drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik, Brahim Mehmetaj – drejtor i Drejtorisë së Pronës, Premtim Fazliu – nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale, Sibel Halimi – drejtore e Drejtorisë së Kulturës, Lindita Hajdari nga Drejtoria e Kulturës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, me këtë:

### REND DITE

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të seancave të jashtëzakonshme dhe të seancës së nëntë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026;
3. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;
4. Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues Çagllavicë;
5. Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Zona Ekonomike”;
6. Propozim-vendimi për përkrahje financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar;
7. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për Artin dhe Kulturën 2026-2031;
8. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor dhe caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të kultit – xhamisë në fshatin Orloviq, të Komunës së Prishtinës;

9. Propozim-vendimi për miratimin e Projektregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës;
10. Propozim-vendimi për miratimin e kërkesës së përfaqësuesve të lagjes “Kodra e Diellit II”, për themelimin e komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e Aktvendimit mbi eksproprijim, nr. 07. nr. 465-25/85, të datës 8 korrik 1985;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

**Kryesuesi** i përshëndeti të gjithë të pranishmit në mbledhje, duke ju uruar një vit sa më të mbarë dhe të suksesshëm.

**Bahri Gashi:** - tha se propozoj si pikë të rendit të ditës Propozim-vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet, nr. 01-020/05-69249/23, dt. 3.4.2023. Ai shtoi se në këtë vendim duhet zëvendësuar tre anëtarë të këtij komisioni, dy prej tyre nga ekzekutivi dhe një nga Drejtoria e Urbanizmit.

**Kryesuesi:** - tha se ndoshta do të ishte mirë të veprimi ashtu si jemi pajtuar që në mbledhje të KPF-së, të mos shtojmë pika të reja për rend të ditës në mbledhje të Kuvendit.

**Fatos Dibra:** - tha se unë e kam sqaruar në mbledhjet e kaluara të KPF-së, por edhe përmes emailit zyrtar që në mbledhje të KPF-së mund të merren vetëm rekomandime për rend të ditës për mbledhje të Kuvendit.

Pas këtij sqarimi u votu ky rekomandim, me 6 vota për, asnjë kundër dhe 4 abstenime që pika e propozuar nga z. Bahri Gashi, Propozim-vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në kryeqytet, nr. 01-020/05-69249/23, dt. 3.4.2023, të jetë si rekomandim për mbledhje të Kuvendit.

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së njëmbëdhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Me 9 (nëntë) vota për, asnjë kundër dhe 1 (një) abstenim, kalon pika e parë e rendit të ditës.**

#### **Pika e dytë**

**Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026.**

**Premtime Preniqi:** - tha ky plan ka qenë në rend të ditës edhe në mbledhjet e kaluara, por për shkak të ndërprerjeve të mbledhjeve nuk ka arritur të shqyrtohet. Ajo tha se të gjitha procedurat e diskutimit publik lidhur me këtë propozim-vendim janë të përfunduara gjatë vitit të kaluar dhe se

do ta pyes zyrën ligjore, si të veprojmë me këtë rast pasi tash jemi në vitin 2025, ndërsa plani parashihet në vitet 2024-2024?

**Fatos Dibra:** - tha se do ta shikojmë dhe do të ju kthejmë një përgjigje deri në mbledhje të Kuvendit, por nuk shoh ndonjë arsye ta miratojmë një vendim që ka të bëjë me vitin e kaluar.

**Premtime Preniqi:** - tha se nëse e parashohim për vitet 2025-2027, duhet që edhe njëherë të mbledhet grupi t'i bëjmë prapë ndryshimet, ta dërgojmë në diskutim publik dhe besoj prapë do të përsëritet e njëjta procedurë. Ajo tha se nëse jeni të pajtimit ta ndryshojmë dhe ta miratojmë vetëm për dy vite pra, 2025-2026.

**Osman Bilaca:** - tha, Premtime ndryshojë vendimin dhe planin vetëm për dy vite 2025-2026 dhe e dërgojmë në Sektorin e Kuvendit që të përcillet me ndryshime të anëtarët.

**Të gjitha grupet politike u dakorduan se e mbështesin këtë propozim me këto ndryshime.**

**Pika e tretë**

**Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025.**

**Gëzim Sveçla:** - pyeti se kush do ta propozojë këtë pikë të rendit të ditës?

**Nora Kelmendi:** - tha se para se t'i propozojmë emrat për formimin e grupit punues, a ka mundësi të na sjellni një raport të punës së Kuvendit për vitin 2024?

**Kryesuesi:** - tha se para mbledhjes së Kuvendit, Sektori për punë të Kuvendit do ta përcjellë te anëtarët, Raportin e punës së Kuvendit për vitin 2024.

**Pika e katërt**

**Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues Çagllavicë.**

**Arbër Sadiki:** - tha se koha e përcjelljes së materialeve përmes we-transferit ndoshta është e pamjaftueshme. Ai tha se unë jam i gatshëm të jap shpjegime edhe njëherë ose këtu ose në mbledhje të Kuvendit, ku prezentimi do të bëhet në detaje për të gjithë anëtarët. Ai tha se ky vendim përfshin pjesën jug-perëndimore të Prishtinës, një pjesë që kufizohet me Graçanicën e vetmja e patrajtuar më parë. Sadiki shtoi se ne do t'i ndjekim të gjitha procedurat ligjore dhe ta përgatitim planin në formën më të mirë, për ta përcjell pastaj për dëgjim publik.

**Nora Kelmendi:** - tha se në emailin të cilin e kemi pranuar është përcjellur një link, në të cilin gjendet vetëm një prezentim, pjesa e arsyetimit, por jo vendimi dhe disa harta. Ajo pyeti drejtorin z. Arbër Sadiki se çfarë sqarojnë këto harta dhe pse nuk është i bashkëngjitur vendimi i këtij propozimi?

**Arbër Sadiki:** - tha se ky plan konsiderohet që ka mjaftueshëm ndoshta edhe më tepër materiale, sepse është analizuar në pikat kyçe ku mund të intervenohet në atë zonë. Sadiki tha se hartat janë bukur të qarta sepse shumica e tyre janë të vendosura mbi incizimin e google word, ashtu siç shihet dhe në raport. Sa i përket pjesës së vendimit, është punuar sipas një drafti standart të pranuar, ndërsa pjesa e arsyetimit është punuar nga unë.

**Nora Kelmendi:** - tha, në materialin që ne kemi pranuar, nuk ka as fleta poseduese dhe as vendim. Ajo pyeti drejtorin se a mund të kalojë ky plan, pa u miratuar PZHK-ja?

**Arbër Sadiki:** - tha se këtë problem e kemi pasur gjithmonë, çdo plan i miratuar ka kaluar përmes ministrisë, pastaj ata japin mendimin e tyre. Ai tha se ne kemi vepruar me këtë plan njësoj si edhe me planet tjera dhe puna jonë është ta kryejmë pjesën teknike dhe ta sjellim te ju, pastaj është në dorën tuaj nëse dëshironi ta kalojmë tutje apo jo.

**Fatos Dibra:** - tha se një vendim për fillim të hartimit të planit përveç kufirit, hapësirës s'ka asgjë tjetër sepse duhet të formohet një komision me draftu planin dhe me e ndryshuar planin për diskutim publik.

**Arbër Sadiki:** - tha se nëse është vetëm pjesa e vendimit ajo e cila mungon, ne do ta përcjellim deri për mbledhje të Kuvendit apo edhe sot deri në fund të orarit. Ai tha se mënyra e prezentimit të hartave në PDF, është forma më e mirë e leximit të hartave.

**Jeta Rafuna** - tha se një pjesë nga grupi jonë ka probleme me emailat dhe linqet e përcjellura. Ajo tha se tash pas arsyetimit të planit nga drejtori besoj se po ashtu do ta kemi një prezentim më të detajizuar në mbledhje të Kuvendit. Ajo tha se grupi jonë do ta diskutojë edhe njëherë dhe ta japim përgjigjen përfundimtare për këtë propozim.

**Gëzim Sveçla:** - tha se a është ky është vetëm hapi i parë i inicimit, mandej vjen një draft për votim në Kuvend për të dalë në dëgjim publik, pastaj është dëgjimi publik dhe në fund është drafti final që prapë vjen për miratim.

**Arbër Sadiki:** - tha se ky plan do të vjen tri herë të ju në Kuvend për miratim.

**Leutrim Retkoceri:** - tha se mënyra e përcjelljes së materialeve përmes we-transfer duhet të qëndrojë më gjatë dhe jo vetëm tri ditë. Ai tha se çështja tjetër është moskompletimi i dokumentacioneve sepse do të ishte mirë që t'i pranojmë materialet e plota dhe të vijmë të përgatitur në mbledhje. Retkoceri tha se edhe ky plan ashtu si planet e kaluara si p.sh ai i Kalabrisë nuk është mënyra më e mirë e miratimit pa Plan zhvillimor komunal. Ai tha se më e mira do të ishte të filloni edhe njëherë nga zero, pastaj materialin e kompetuar ta përcjellni për mbledhje të Kuvendit.

**Bahri Gashi:** - tha se përkundër vërejtjeve të marra nga kolegët e disa prej tyre edhe të drejta, sepse mungesa e materialeve dhe forma jo e duhur e pranimit të materialeve përmes we-transfer nuk është problem që na takon neve për të zgjedhur. Ai tha se pas arsyetimit të planit nga drejtori z. Sadiki, ne si grup parlamentar do ta mbështesim.

**Arbër Sadiki:** - tha se ajo çfarë më takon mua, është përcjellja e kompletuar e materialeve te organi kompetent, pastaj pjesa tjetër e përcjelljes së materialeve te anëtarët e Kuvendit iu takon atyre. Ai tha se për çdo problem qoftë edhe ai i natyrës teknike, jam i gatshëm që çdoherë të jap sqarime dhe të diskutojmë.

#### **Pika e pestë**

**Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Zona Ekonomike"**

**Arbër Sadiki:** - tha se pjesa më e rëndësishme dhe besoj se ajo kryesore se çfarë ju intereson juve rreth këtij vendimi është se për cilën zonë bëhet fjalë, cilët janë kufijtë e këtij plani dhe cilët janë raportet me plane ekzistuese. Ai tha se Plani për Zonën ekonomike përfshin pjesën e cila është në mes të rrugës që shkon për Mitrovicë dhe rruga që shkon për Fushë Kosovë, e cila është e paplanifikuar në planin e hollësishëm ekzistues. Sadiki tha se ideja e analizimit si tërësi e këtyre dy rrugëve për ne është problemi kryesor, por mendoj se plani i ri i cili mund të jetë më praktik në implementim dhe me këto dy plane kufijtë e Prishtinës pothuajse i mbyllim me planin tonë.

**Nora Kelmendi:** - tha se më datë 6.12.2024 e ka dërguar një email në lidhje me Zonën ekonomike dhe nuk kam pranuar përgjigje! Ajo tha se prapë duke u bazuar në ato pyetje, të cilat i kam drejtuar, janë bërë ndryshime në hartë. Nora tha se materiali i përcjellur te anëtarët ashtu si edhe vendimi paraprak përmban vetëm pjesën e arsyetimit, por jo edhe vendimin.

**Arbër Sadiki:** - tha se e kam pranuar emailin e dërguar dhe ashtu siç po shihet në hartë janë bërë ndryshimet e kërkuara.

**Jeta Rafuna:** - tha se e njëjta pikë ka qenë në prezentim edhe në mbledhjen e kaluar dhe ne si grup parlamentar e përkrahim.

**Bahri Gashi:** - tha se edhe ne si grup parlamentar do ta mbështesim këtë propozim.

**Gëzim Sveçla:** - pyeti drejtorin, se sa është pjesa e sipërfaqes që po shtohet në këtë plan?

**Arbër Sadiki:** - tha se plani përfshin një sipërfaqe gjithsej 370 hektarë, diku 55 % e kësaj sipërfaqeje është pjesa e shtuar dhe është ideja e rishikimit të kësaj zone.

**Gëzim Sveçla:** - tha si të rishikohen, cili është statusi aktual i tyre?

**Arbër Sadiki:** - tha se statusi aktual në plan nuk është i përfshirë, një pjesë është zonë ekonomike një pjesë zonë e veçantë. Ai tha se në atë pjesë shtrihen disa institucione të tregut që prapë do të trajtohen dhe AKI-ja.

**Gëzim Sveçla:** - tha se hapësira prej 200 hektarësh, çfarë pronësie ka?

**Arbër Sadiki:** - tha kjo hapsirë ka pronësi të përziera. Ai tha se aty kanë qenë shumica e pronave publike, mirëpo në procesin e privatizimit, aty janë privatizuar dhe historikisht ka qenë zona ekonomike.

**Gëzim Sveçla:** - tha se është një rryp i vetëm, i cili ka mbet rrip i gjelbër prej rrethit të madh që i themi, nga Fushë Kosova deri në Orlovicë në Shakabaj. Ajo e përfshin këtë zonë.

**Arbër Sadiki:** - tha se ajo pjesë nuk përfshihet, por hartat e sqarojnë shumë mirë. Ai tha se pjesa e rrugës për Mitrovicë në kahjen e djathtë e cila është po ashtu zonë ekonomike nuk përfshihet në plan, sepse atëherë i bie që ta rishikojmë të gjithë zonën ekonomike. Drejtori tha se ajo pjesë veçse ka filluar të rregullohet dhe të zhvillohet sepse njerëzit janë pajtuar, ndërsa pjesa tjetër është shumë pak e definuar.

**Gëzim Sveçla:** - pyeti drejtorin pse nuk janë pajtuar njerëzit?

**Arbër Sadiki:** - tha se ajo çfarë po dëshirojmë është rishikimi i kësaj zone e cila nuk është duke u zhvilluar dhe cilat janë mundësitë reale të zhvillimit në këtë pjesë. Ai tha se ne do të veprojmë sipas të gjitha dispozitave ligjore dhe për çdo gjë e cila nuk është në përputhshëmri me bindjet e juaja do ta kenë mundësinë ju vetë për të vendosur në Kuvend.

**Gëzim Sveçla:** - tha se a nuk ka pasë mundësi këta 200 hektarë me u trajtuar ndaras nga zona ekonomike dhe pse me u trajtuar sikur zonë ekonomike.

**Arbër Sadiki:** - tha se ka pas mundësi, por meqenëse ne e kemi mundësinë që edhe pjesa tjetër e cila është as 3% e planit, nuk është e realizuar. Ai tha nëse ti merresh me atë pjesë, me të njëjtën tërësi, të njëjtin funksion edhe nuk i shikon ato probleme në kuptimin e planifikimit për mua nuk ka sens. Drejtori tha se ne kemi përgjegjësi ndaj qytetarëve të asaj pjese sepse ata janë në probleme që 15 vite dhe t'i thuash se nuk merrem me këtë punë kur ti veçse je duke punuar në atë zonë nuk është e drejtë.

### **Pika e gjashtë**

#### **Propozim - vendimi për përkrahjen financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar**

**Premtim Fazliu:** - tha se ky propozim-vendim për përkrahjen financiare është në 5 kompani, duke i përfshirë burimet financiare të familjes, të cilat strehojnë fëmijë, e në veçanti fëmijët të cilët janë me aftësi të kufizuara dhe për familjet të cilat janë në gatishmëri për strehim familjar në ç'rast parashihet strehimi edhe për të rriturit e moshës mbi 18 deri 26 vjeç. Ai tha se për aq kohë sa shumica prej tyre në statusin ekzistues janë me aftësi të kufizuar, kemi propozuar që vlera e sigurimit të jetë deri në 450 euro, pa marrë parasysh edhe karakteristikat e personave të rritur.

**Gëzim Sveçla:** - tha se këta parametrat financiar, pse janë përcaktuar kështu? A ka pas diçka që janë përcaktuar, a nuk kemi pasë më shumë buxhet a po çka.

**Premtim Fazliu:** - tha se shumata të cilat janë propozuar këtu janë të njëjtat qysh praktikohen nga niveli qendror, përveçse të të rriturit për shkak se nuk ka kaluar ligji janë të arbitit të kaluar dhe administrativ që e rregullon subvencionimin e të rriturve në strehim familjar nuk është miratuar. Fazliu tha se duke përjashtuar pikën katër e cila nuk është e rregulluar, është model ose praktikë që është marrë prej Ministrisë së Drejtësisë, d.m.th që fëmijët të cilët janë në strehim familjar, paguhen 350 euro në muaj, ndërkaq ata që janë me aftësi të kufizuar paguhen 450 euro. Ai shtoi se nëse e kalkulojmë nga 200 euro për familje dhe 250 për fëmijë që janë me aftësi të kufizuar del shuma 450 euro.

**Gëzim Sveçla:** - tha se shuma e cila është vendosur për këtë subvencionim është duke u bazuar me atë të nivelit qendror si e theksuat edhe ju apo edhe mund të rritet pasi siç e dimë kostoja e jetesës në Prishtinë është më e lartë se në qytetet tjera.

**Premtim Fazliu:** - tha se ideja është që nëpërmjet linjës së subvencioneve të Drejtorisë së Mirëqenies Sociale e cila këtë vit është 800,000 euro, shuma mundet edhe me u rrit, mirëpo pastaj kemi disbalanc kur hyn në fuqi udhëzimi administrativ nga niveli qendror. Ai tha se kjo është vetëm përpjekje për stimulimin e familjeve, të cilat kanë strehim familjar dhe për familjet e reja që dëshirojnë të ndihmojnë në strehim. Fazliu tha se synimi jonë është që me i pas dhjetë familje strehuese për aq kohë sa numri i fëmijëve të braktisur, sidomos atyre me aftësi të kufizuar është në rritje e sipër.

**Gëzim Sveçla:** - tha se nëse qëllimi i drejtorisë dhe i komunës në përgjithësi është rritja e numrit të familjeve strehuese, atëherë rritja e këtyre pagesave kishte me qenë stimulim për këtë çështje dhe mendoj se nuk paraqet ndonjë problem.

**Premtim Fazliu:** - tha se është iniciativë e brendshme komunale që pagesat të bëhen mujore se nëse krijojmë një stabilitet më të qëndrueshëm financiar dhe jo sikur herave të kaluara siç kemi vepruar duke ndarë një shumë vjetore nëpërmes Kuvendit komunal.

**Osman Bilaca:** - pyeti se këto tri familjet strehuese nga sa fëmijë i kanë.

**Premtim Fazliu:** - tha se për momentin nga një fëmijë dhe dy prej tyre janë me aftësi të kufizuara.

**Bahri Gash:** - tha sipas propozim-vendimit pas 12 muajve të marrjes së kësaj ndihme që i ofrohet familjes, ata kanë mundësi të vazhdimin sipas vlerësimit të QPS-së. Ai tha nëse ka mundësi që të na i tregoni këto kritere dhe pse jo të jenë edhe pjesë e vendimit.

**Premtim Fazliu:** - tha se ajo që deklarova më lart për numrin e familjeve strehuese është statistikisht zyrtare nëpërmjet organeve të kujdestarisë të Qendrës për punë sociale.

**Pika e shtatë:**

**Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për Artin dhe Kulturën 2026-2031.**

**Sibel Halimi:** - tha se kjo strategji për herë të parë bëhet në kuadër të Drejtorisë për Kulturë dhe Art dhe garanton një përditësim në inovacion edhe përditësim të çështjeve që kanë të bëjnë me kulturën. Ajo tha se strategjia ka rëndësi të ndryshme, e që prek thajse të gjitha zhanret e artit dhe kulturës në kryeqytet.

**Gëzim Sveçla:** - tha se në këtë përmbajtje lexova ndarjen e buxhetit të Prishtinës për kulturën 2020-2024 dhe nuk e di pse përfshihen veprimet e së kaluarës përderisa jemi duke krijuar një Strategji të Prishtinës për Artin dhe Kulturën për vitet e ardhshme 2026-2031.

**Sibel Halimi:** - tha se me siguri ka ndodhur ndonjë gabim teknik i cili besoj se do të rregullohet menjëherë, pasi që kjo strategji është për të ardhmen, pra për vitet 2026-2031.

**Pika e tetë**

**Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor dhe caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të kultit – xhamisë në fshatin Orlovic, të Komunës së Prishtinës.**

**Arbër Sadiki:** - tha se kemi pasur një kërkesë prej kulturës për një incizim të gjeodezisë, në të cilin është kërkuar të përcaktohet sipërfaqja, në të cilën gjendet ndërtesa parashkollore dhe nuk kemi arritur deri sot në mëngjes për ta përcjell. Ai tha se bëhet fjalë për një parcelë të AKP-së, një ndërtesë e kuqe dhe ka kaluar një kohë e gjatë derisa kemi arritur ta krijojmë një zgjidhje. Ai tha se zgjidhja është caktimi i lokacionit për ndërtimin e xhamisë dhe ndërtimin e një institucioni parashkollor.

**Brahim Mehmetaj:** - përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe ju ofroi bashkëpunimin esencial për çdo informacion me rëndësi e që ka të bëjë me drejtorinë të cilën tani ai e udhëheq. Ai tha se do të

mundohem që çdoherë të gjitha pikat të cilat paraqiten për asamble të vinë me material të kompletuar sepse të diskutohet në këtë mbledhje apo atë të Kuvendit për materiale jo të plota mendoj se është jo e kuptueshme. Mehmetaj tha se kemi komunikuar me Drejtorinë e Kadastrit dhe i kemi informatat se certifikata e pronës është në emër të AKP-së, ndërsa plani dhe skica ka qenë e pamundur të na bëhen për shkak se realiteti në terren është ndryshe. Ai tha se në maj të vitit 2024 është njoftuar Drejtoria e Pronës dhe Komuna e Prishtinës që AKP-ja dëshiron ta privatizojë këtë pjesë dhe thotë se a keni interes të merreni me këtë çështje? Drejtori tregoi se në muajin e tetë 2024, Drejtoria e Pronës ka kthyer përgjigje, ku thotë se po kemi interes dhe këtu është ndalur ky proces.

**Nora Kelmendi:** - tha se sot i kam pranuar certifikatat e pronës dhe kopjet e planit. Aty ishte e bashkëngjitur edhe certifikata 44/25, parcelë e KBI-së, ndërsa në vendim nuk është. Ajo pyeti se a do t'i bashkëngjitet kjo parcelë apo jo dhe nuk e di si do të veproni pa ndonjë marrëveshje me AKP-në?

**Arbër Sadiki:** - tha se po e ngatërrojmë me fazën që na pret sepse kjo pikë do të vijë prapë në Kuvend kur të jepet në shfrytëzim. Ai tha se hapi i parë për me pasur arsyetim për të marrë parcelën prej AKP-së duhet me qenë destinim publik, sepse ne nuk mundemi me i marrë destinimet të cilat nuk janë publike.

**Fatos Dibra:** - tha pas dërgimit të njoftimit të AKP-së se do të dalë në privatizim dhe të pyet se a keni interes, ne si komunë duhet që ta arsyetojmë këtë interes. Ai tha se çështja e këtij planifikimi pra lidhet me pjesën e arsytimit që duhet t'i drejtohem AKP-së.

**Gëzim Sveçla:** - tha se ky propozim është dashur të na vjen shumë më herët dhe jo tash në kohë fushate sepse këto negociata paskan filluar nga muaji maj, ashtu siç u deklarua drejtori.

#### **Pika e nëntë**

**Propozim-vendimi për miratimin e Projektregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës**

**Kryesuesi:** - tha se pasi nuk kemi askënd për prezentimin e kësaj pike po e largojmë nga rendi i ditës.

#### **Pika e dhjetë**

**Propozim-vendimi për miratimin e kërkesës së përfaqësuesve të lagjes “Kodra e Diellit II”, për themelimin e komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e Aktvendimit mbi eksproprijim, nr.07.nr.465-25/85, të datës 8 korrik 1985**

**Kryesuesi:** - tha se edhe këtë pikë e largojmë nga rendi i ditës për arsyen e njëjtë.

#### **Pika e njëmbëdhjetë**

**Të ndryshme.**

**Kryesuesi:** - tha se e kam një kërkesë të një qytetarit, i cili ka një fëmijë të sëmurë dhe që trajtohet nga janari 2024 në Turqi, për shkak të një sëmundjeje të rëndë. Ai tha se fjala është për Nina Dragushën. Babai i saj Leutrimi e ka bërë një kërkesë të cilën besoj edhe juve ua ka përcjell dhe ka kërkuar mbështetjen në shumën prej 10,000 euro për dërgimin e fëmijës jashtë vendit për shërim të plotë.



**Dhurata Jahaj:** - pyeti se a duhet që çdo vit t'i ndahen nga 10,000 euro?

**Kryesuesi:** - tha se kërkesa është e drejtuar vetëm për 10,000 euro.

**Gëzim Sveçla:** - tha se nuk po e dimë se për çfarë arsye, por e pranojmë dokumentacionin dhe e shohim. Ai tha se për shërim jashtë vendit është fondi për sigurime shëndetësore, i cili i trajton rastet të cilat nuk mundën me u trajtuar në institucione shëndetësore vendore. Sveçla tha se e besoj rastin dhe i dëshiroj shërim të plotë, por do të ishte i duhur edhe verifikimi nga ky institucion.

**Kryesuesi:** - tha se pas mbledhjes do t'ju përcjellim edhe njëherë materialin dhe pastaj ta shqyrtojmë si propozim në mbledhje të Kuvendit.

Mbledhja mbaroi në orën 11:40.

Procesmbajtësi  
Arton Brahim

Kryesues i Komitetit  
Fehmi Kupina

